



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:202664

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06212779

P.nr.246/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i përgjithshëm- Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit F.F., nga Vushtria, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av.V.B., për shkak të dyshimi të bazuar mirë për kryerjen e veprës penale *Lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par. 1 nën par.1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1197/24 të datë 06.09.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik të datës 17.09.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Vyryte Gërvalla, të dëmtuarës B.F., të pandehurit F.F. dhe mbrojtëses së të pandehurit të caktuar sipas detyrës zyrtare av.V.B., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.09.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: F.F., nga i ati I., e ëma B..., e vajzërisë H..., data e lindjes..., në Vushtrri, ku edhe jeton, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike – rast social, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Më datë 15.07.2024, rreth orës 13:00, në rrugën “Adem Jashari”, komuna e Vushtrrisë, në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, dhe atë nënës së tij viktimës së ndjeshme, këtu të dëmtuarës B.F., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara dyshon që i pandehuri i’ka marr vajzës së saj një telefon, e njëjta i kërkon atij që të e kthej telefonin, ku i pandehuri në shenjë revolte merr një mjet të fortë – shpuzore dhe e hedh në pllaka, pastaj thyen derën e banjos së shtëpisë, si dhe i vërsulet të dëmtuarës duke e grithur në tërë fytyrën, ku si pasoj kjo e fundit pëson dëmtime trupore,

- Me këtë ka kryer veprën penale *Lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par.3, nën par.3.1 e lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 7, 21, 38, 39, 41, 46, 48, 49, 69, 70, 76, dhe neneve 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 449, 450, 452, 460, 515 të KPPRK-së:

## E GJYKON

I. Të pandehurit F.F.: i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe atë nga data 15.07.2024, e gjer me datë 17.09.2024, duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së, të pandehurit i është llogaritur me rastin e shqiptimit të dënimit.

## DHE

Në mbështetje të nenit 86 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 514 dhe 515 të KPPK-së, të pandehurit F.F. kjo Gjykatë i;

## SHQIPTON

### II. Masën e Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në liri

- Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri do të ekzekutohet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë. I pandehuri obligohet që t'i nënshtrohet trajtimit të detyruar psikiatrik në liri dhe të paraqitet në këtë institucion sipas kohës, terminëve dhe rekomandimit të mjekëve, gjithashtu të përdorë terapinë sipas rekomandimit të ekspertëve të kësaj qendër. I pandehuri duhet të paraqitet tek ky institucion pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Masa e trajtimit të detyruar do zgjasë për aq kohë sa është nevojshme për trajtimin e të pandehurit, po jo më shumë se tre vite ashtu siç përcaktohet në nenin 86 par.4 të KPRK-së.
- Qendra e Shëndetit Mendor në Mitrovicë – detyrohet ta pranojë në trajtim të pandehurin sipas këtij aktgjykimi, si dhe t'i dërgoi gjykatës raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajnimit për të pandehurin. Qendra obligohet t'i raportoj gjykatës së paku njëherë në dy muaj dhe të njoftojë gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.
- I pandehuri paralajmërohet se në rast mosrespektimit të kësaj mase të shqiptuar, në rast se nuk merr pjesë në trajtim, refuzon apo kanoset që të kryej ndonjë veprë tjetër penale, në këto raste Gjykata mund të vendosë për ndërrimin e masës dhe shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar me ndalim.

III. Pala e dëmtuar B.F. ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore - juridike lidhur me këtë çështje penale.

IV. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20 (njëzet) euro si dhe në emër të kompensimit të programit për viktimat e krimit të paguaj shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e formës së prerë të këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

#### *Pjesa hyrëse e arsyetimit të aktgjykimit*

Prokuroria Themelore në Mitrovice, Departamenti i përgjithshëm, me datë 06.09.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1197/24, me propozim për shqiptim të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, kundër të pandehurit F.F., nga Vushtrria, për shkak të dyshimit të bazuar mirë për kryerjen e veprës penale *Lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4 të KPRK-së.

#### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.09.2024,

në të cilën seancë të pandehurit F.F., pasi që është njoftuar me të drejtat e tij, i është lexuar aktakuza dhe gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohe lidhur me fajësinë, ku i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke shtuar se është penduar thellë për kryerjen e veprave penale, se i kërkon falje të dëmtuarës përkatësisht nënës së tij, se i premton gjykatës se më asnjëherë nuk do të përsëris veprën penale dhe po ashtu i kërkon falje të dëmtuarës përkatësisht nënës së tij.

#### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokuroja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë sipas gjendjes dhe kualifikimet ligjor në aktakuzë, i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë sepse janë plotësuar të gjitha kushtet për pranimin e fajësisë se tij, ndërkaq me rastin e përcaktimit të dënimit të ketë parasysh rrethana lehtësuese dhe rënduese siç janë cekur në pikën IV të propozimit në aktakuzë dhe të elaboruar në faqen VII të arsyetimit në aktakuzë me theks të veçantë të merret se i njëjti nuk ka të kaluar kriminale dhe këtë e vërtetojmë nga mbi bazë të certifikatës mbi evidencat penale të lëshuar nga KGJK ku vërtetohet se i njëjti nuk ka qenë asnjëherë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë.

Duke marr parasysh se i pandehuri i është nënshtruar ekzaminimit psikiatrik dhe se veprën penale e ka kryer në aftësi të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, i propozon gjykatës ashtu si në

propozimin në aktakuzë që të njëjtit krahas dënimit të i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në qendrën e shëndetit mendor në Mitrovicë, ashtu siç është udhëzuar edhe në ekspertizën e Institutit të Psikiatrisë Forenzike.

E dëmtuara B.F. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është hera e parë që ka ndodhur një gjë e tillë dhe kërkon nga gjykata që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim sa më i butë, po ashtu ka shtuar se heqë dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

Mbrojtësja e të pandehurit e caktuar sipas detyrës zyrtare av.V.B., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë të dhënë nga i mbrojturi i saj pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtën, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, ashtu që i propozon gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i mbrojturi i saj.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit numër të rastit 2024-BD-638, i datës 15.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin B.F., i datës 15.07.2024, procesverbali i marrjes në pyetje i të dyshuarit F.F., i datës 15.07.2024, raporti i oficerit, i datës 15.07.2024, raporti ditor i dhunës familjare, i datës 15.07.2024, raporti policor, i datës 15.07.2024, raporti mjekësor për të dëmtuarën B.F. në spitalin “Sheikh Zayed” në Vushtrri, i datës 15.07.2024 dhe fotoalbumi në shtojcë prej 8 fotografive.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 185 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprën penale Lëndimi i lehtë trupor e kryen “*Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër; zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër; ose dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*”. Ndërsa në par.3 nën par.3.1 të nenit 185 është përcaktuar se “*Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto*

*karakteristika të mbrojtura kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni”.*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me paragrafin 1 nën par.1.4 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e rrezikshmërisë shoqërore që paraqitë kjo vepër penale, faktin se kjo vepër penale është kryer brenda marrëdhënies familjare dhe vetë ligji e parasheh si rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, kërkim faljen që i'a ka bërë të dëmtuarës dhe faktin se është hera e parë që i njëjti ka ra ndesh me ligjin, përkatësisht nuk është më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti për veprën e lartcekur, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Vendimi lidhur me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri*

Neni 86 par.1 i KPRK-së përcakton se “Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se: 1.1. ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë vepër penale; 1.2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penal; dhe 1.3. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz”.

Në rastin konkret, gjykata pas vlerësimit të ekspertizës psikiatrike të datë 02.08.2024, i kryer nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës , gjeti se nuk është kontestuese se i pandehuri veprat penale i ka kryer në gjendje të paaftësisë së zvogëluar mendore, ndërsa në mënyrë kumulative përmbushen edhe të gjitha kushtet e parapara me nenin 86 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3, andaj duke vepruar edhe në pajtim me nenin 503 të KPRK-së, vendosi si në pikën III të dispozitivit, ashtu

që ndaj të pandehurit krahas dënimit të kushtëzuar me burgim, shqiptoj edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë.

*Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës dhe kërkesën pasurore juridike.*

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore – juridike gjykata e morri në bazë të nenit 460 të KPPK-së, ku është përcaktuar se: *“Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe”,* kjo pasi që e dëmtuara ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje juridiko penale.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par.2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA VUSHTRRI**

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal,

P.nr.246/2024, datë 26.09.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga momenti i marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.